



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2024:028726

Datë: 22.11.2024

Numri i dokumentit: 06495420

C.nr.1164/24

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil, gjyqtarja Edona Zuzaki, me bashkëpunëtoren profesionale Bionda Rexhepi, në çështjen juridike kontestimore të paditëses N.A. nga Gjilani, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson K.B.¹, avokat nga Gjilani, kundër të paditurës Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës, me objekt kontesti kompensimi i pagës së 13-të dhe shujtës mujore, me vlerë të kontestit 1,111.4 euro, jashtë seancës, me datë 20.11.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET në tërësi e pabazuar kërkesëpadia e paditëses N.A. nga Gjilani, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës, që t'ia kompensojë pagën e 13-të, për vitin 2020, në vlerën e shumës së pagës bazë prej 425.00 euro dhe shujtën mujore për periudhën nga data 01.02.2023 – 31.05.2024, në shumën prej 686.4 euro, apo shumën e përgjithshme prej 1,111.4 euro, me kamatë ligjore prej 8 %, nga dita e paraqitjes së padisë në gjykatë, e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditë, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

II. Secila palë i bart shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësja, përmes të autorizuarit të saj, më datë 09.01.2024 ka paraqitur padi në këtë gjykatë kundër të paditurës për kompensimin e pagës së 13-të, ndërsa me precizimin e kërkesëpadisë të datës 12.06.2024 ka kërkuar edhe kompensimin e shujtës mujore, në vlerë të kontestit prej 1,111.4 euro.

Në padi dhe precizim të kërkesëpadisë ka theksuar, se është në marrëdhënie pune te e paditura në Spitalin e Përgjithshëm në Gjilan, në cilësinë e infermieres dhe realizon pagë bazë prej 425.00 euro. Bazuar në dispozitat e Kontratës Kolektive Sektoriale, ka konsideruar se i takon realizimi i pagës së

¹ Në padinë fillestare është përfaqësuar me autorizim nga avokati F.S., i cili me email të datës 06.08.2024 ka njoftuar gjykatën se më datë 30.07.2024 ka dhënë betimin për noter, e me këtë rast ka dhënë dorëheqje nga pozita e avokatit. Për të gjitha lëndët civile ku ka qenë i autorizuar ka njoftuar se autorizimin ia ka bartur avokatit K.B.. Në autorizimin e bashkëngjitur shkresave të lëndës konstatohet përmbajtja “Nëse i autorizuari në fjalë për shkak të pengesave objektive nuk mund t’i ushtrojë autorizimet e dhëna nga unë, atëherë këtë autorizim mund ta bartë në persona të tretë pa pasur nevojë për pëlqimin tim si autorizimdhënës”.

13-të, për vitin 2020. Ka theksuar se ka kërkuar paraprakisht nga e paditura këtë kompensim, mirëpo e njëjta nuk është përgjigjur në kërkesë dhe nuk ka kryer obligimin që i del nga KKS. Sipas Raportit të Auditimit të Pasqyrave Vjetore Financiare të SHSKUK për vitin 2020, e paditura ka pasur suficit prej 6,043,556.95 euro. Me nxjerrjen e Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, KO.nr.79/23, paditëses i takon edhe e drejta në kompensimin e shumës mujore prej 45.76 euro, e cila shumë i ka takuar deri para hyrjes në fuqi të Ligjit mbi Pagat. Gjykatës i ka propozuar të aprovojë të bazuar kërkesëpadinë e paditëses dhe të detyroj të paditurën në kompensimin e shumës prej 1,111.4 euro. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në shumën prej 104.00 euro, për përpilim të padisë dhe 20.00 euro, për taksë gjyqësore.

E paditura në përgjigje në padi ka deklaruar se e kundërshton në tërësi të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke theksuar se kërkesës i mungon baza ligjore pasi Kontrata Kolektive Sektoriale e Shëndetësisë ka qenë në fuqi nga data 11.06.2018 deri më datë 10.06.2021, pra ka përfunduar. Për më tepër, sa i përket mundësive buxhetore të punëdhënësit, ka theksuar se e paditura si institucion shëndetësor i nivelit sekondar/dytësor nuk ka pasur mundësi të bëj kompensimin e shpërblimit për pagën e 13-të, e për këtë kanë njoftimin nga Shërbimi i Financave brenda Spitalit të Përgjithshëm në Gjilan dhe njoftimin nga Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës - Spitali i Përgjithshëm në Gjilan, që dëshmon se për periudhën 2018-2020 asnjëherë nuk kanë pasur buxhet të mjaftueshëm për të mbuluar nevojat e institucionit, e aq më tepër për paga dhe mëditje, duke qenë gjithnjë në deficit dhe duke u mbuluar nga Ministria e Financave – Thesari në fundvit për të ekzekutuar pagesën e rregullt të pagave mujore. Në vitin 2020 ka shtuar se për shkak të gjendjes sipas pandemisë Covid-19, Qeveria e Republikës së Kosovës ka nxjerrë vendim për pagesë shtesë e cila kishte ndikuar drejtpërdrejtë në rritjen e shpenzimeve, duke pësuar që në këtë vit të ketë tejkalim të buxhetit. Pretendimin se nga të gjeturat e Raportit të Auditimit për Pasqyrat Financiare të vitit 2020 për SHSKUK shihet se ka pasur suficit, e ka kundërshtuar duke shtjelluar se nuk ka pasur suficit në kategorinë e pagave dhe mëditjeve, ndërsa nga kategoritë tjera nuk mund të bëhet pagesa për paga dhe mëditje, pasi është në kundërshtim me Ligjin për Ndarjet Buxhetore të Republikës së Kosovës, nenin 12, paragrafin 6. Gjykatës i ka propozuar të refuzojë të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seance gjyqësore, bazuar në nenin 399, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), në të cilën është përcaktuar se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia. Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërthënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetët kërkesëpadia qartazi janë në kundërthënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura”.

Gjykata ka gjetur se mes palëve nuk është kontestuese se paditësja është e punësuar te e paditura (fakt i provuar nga vërtetimi nr.210/2020 i dt.08.12.2020 i lëshuar nga SHSKUK-Qendra e Shëndetit Mendor në Gjilan) dhe paga bazë e saj është 425.00euro (lista e pagës e lëshuar në emër të paditëses nga BRK për muajin dhjetor të vitit 2020).

Në Kontratën Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë të datës 11.06.2018, në nenin 17, paragrafi 2 është përcaktuar se “Punëmarrësi mund të kompensohet me pagën e 13 (trembëdhjetë) për çdo vit kalendarik, në vlerën e pagës bazë, sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit”.

Zbatimi i KKS-së, aplikohet për periudhën 11.06.2018 – 10.06.2021, ndërsa mos realizimi i pagës së 13-të dhe shujtës mujore, justifikohet vetëm nëse punëdhënësi provon se në asnjë mënyrë nuk ka pasur mundësi buxhetore për të kompensuar këtë pagë. Pra, barrën e të provuarit për mundësitë buxhetore e bart punëdhënësi.

Ky interpretim është në harmoni edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr.40/2023 të datës 27.02.2023 dhe nr.212/2023 të datës 09.10.2023.

Për të provuar mundësitë buxhetore të të paditurës, gjykata ka administruar provat: Njoftimi nr.prot.3823 i dt.21.12.2023 i lëshuar nga Zyra Ligjore e SHSKUK-së; Kërkesa për shtim të kufijve buxhetor për SPGJ-në, nr.01-394 e dt.19.02.2020; Qarkore lidhur me procesin buxhetor dhe orari i dëgjimoreve buxhetore 2018-2020, nr.prot.1666/a i dt.15.08.2017; Njoftimi lidhur me ndarjen buxhetore për paga dhe mëditje nr.01-2970 i dt.25.10.2020 i lëshuar nga SPGJ; dhe Raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës për vitin 2020, i publikuar në Prishtinë, Korrik 2021 nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Sa i përket dokumenteve të brendshme të lëshuara nga SPGJ dhe SHSKUK, gjykata ka vërtetuar faktin se të njëjtit kanë njoftuar që sa i përket mundësive buxhetore në kategorinë paga dhe mëditje, asnjëherë nuk kanë pasur buxhet të mjaftueshëm deri në fund të vitit për të plotësuar nevojat në paga dhe mëditje, ku në tre mujorin e fundit të çdo viti, vazhdimisht kanë pasur deficit në paga dhe këtë e ka mbuluar Ministria e Financave, ndërsa në ekstrakt tabelar kanë pasqyruar dallimin mes buxhetit fillestar dhe buxhetit të shpenzuar.

Sa i përket Raportit të Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës për vitin 2020, të publikuar në Prishtinë, Korrik 2021 nga Zyra Kombëtare e Auditimit, në faqen 23, pikën 3 shihet se është konstatuar se “në vitin 2020, SHSKUK ka shpenzuar 95 % të buxhetit përfundimtar, ose 126,021.739 euro, me një ulje 4 % në krahasim me vitin 2019”. Në ekstraktin tabelar shihet se në vitin 2020 për kategorinë pagat dhe mëditjet, buxheti final ka qenë 76,308,249.55 euro, ndërsa shpenzimet kanë qenë 76,249.758,81 euro.

Nga kjo konstatohet se për 58,490.74 euro, nuk është shfrytëzuar buxheti final nga e paditura sa i përket kategorisë pagat dhe mëditjet.

Gjykata bazuar në nenin 329.1 të LPK-së, vlerësoi se dokumentet e lëshuara nga zyra e financave të SPGJ dhe SHSKUK dhe raporti i auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit kanë fuqinë provuese të saktësisë së të dhënave në të, prandaj të njëjtave gjykata ia fali besimin e plotë.

Gjykata vlerëson se në këtë rast e paditura e ka provuar se nuk ka pasur mundësi buxhetore për kompensimin e pagës së 13-të dhe shujtës mujore, për të punësuarit e saj, ndërsa meqë ky

kompensim realizohet vetëm në bazë të mundësive buxhetore, gjykata e refuzoi të pabazuar kërkesën e paditëses.

Faktin se e paditura nuk ka pasur mundësi buxhetore për këtë kompensim, gjykata e vërtetoi nga dokumentet e theksuara si më sipër, nga të cilat konstatoi se e paditura për vitin 2020 në kategorinë pagat dhe meditet sipas buxhetit fillestar të aprovuar dhe atij të shpenzuar ka pasur deficit, ndërsa sipas buxhetit final dhe atij të shpenzuar ka pasur suficit prej 58,490.74 euro.

Kjo shumë, gjykata vlerëson se nuk paraqet mundësi buxhetore të mjaftueshme për kompensimin e pagës së 13-të dhe shujtës mujore, pasi përbën një shumë që në asnjë mënyrë nuk arrin të kompensojë të gjithë të punësuarit e saj, me ç'rast provon se e paditura nuk ka mundësi buxhetore për këtë kompensim.

Thënë këtë, gjykata vlerëson se është justifikuar mos kompensimi i pagës së 13-të dhe shujtës mujore, në mungesë të mundësive buxhetore, pasi sipas bindjes së lirë së gjykatës nga faktet e paraqitura në padi dhe në përgjigje në padi, administrimi i provave një nga një, si dhe ndërlidhja e provave mes vete (njoftimet financiare të të paditurës dhe raporti i auditimit) vlerësohet se suficitit prej 58,490.74 euro, nuk paraqet mundësi buxhetore mbi bazën e së cilës mund të kompensohet paga e 13-të, për të punësuarit e të paditurës.

Sa i përket kërkesës së paditëses për pagesën e shujtave ditore, gjykata gjen se kërkesa e paditëses mbështetet në Deklaratën e Përbashkët të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Federatës Sindikale të Shëndetësisë së Kosovës të datës 14.10.2008. Nga vlerësimi i kësaj deklarate, gjykata konstaton se kjo deklaratë nuk ka fuqinë e aktit ligjor apo nënligjor dhe nuk paraqet dokument detyrues për të paditurën. Kjo nënkupton se, pavarësisht marrëveshjes mes palëve të përfshira, Deklarata nuk ka kaluar procesin e nevojshëm të miratimit ligjor dhe për këtë arsye nuk mund të përdoret si një dokument ligjor detyrues. Gjykata, duke vlerësuar bazën juridike të kësaj pjese të kërkesëpadisë, konstaton se çdo pretendim për kompensim duhet të mbështetet në një bazë të vlefshme juridike, dhe së këndejmi e paditura nuk mund të detyrohet të përmbushë një kërkesë mbi bazën e një deklarate që nuk ka peshën e një akti ligjor apo nënligjor të miratuar sipas procedurës përkatëse. Për më tepër Ligji për pagat në sektorin publik në nenin 30 [Shtesa për nëpunësen/in e sistemit shëndetësor] dhe në nenin 33 [Shtesa funksionale për nëpunësen/in e sistemit shëndetësor] ka përcaktuar shtesat për nëpunësit e sistemit shëndetësor dhe njëkohësisht ka përcaktuar edhe kushtet për përfitimin e këtyre shtesave, e që për pasojë, gjykata ka konstatuar se shtesa e pretenduar për shujta nuk hyn në kategorinë e këtyre shtesave.

Gjykata ka vlerësuar pretendimin e paditëses se me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese është shpallur i pavlefshëm paragrafi 2, 3 dhe 4 i nenit 41 (shtesa tranzitore) dhe paragrafi 2 i nenit 45 (shfuqizimi) i Ligjit për pagat në sektorin publik dhe mbi këtë bazë paditëses i takon e drejta në kompensim të shujtës ditore. Megjithatë, duke qenë se kërkesa e paditëses nuk mbështetet në një akt ligjor apo nënligjor por në një deklaratë e cila, - për arsyet që u elaboruan më lartë, u konstatua se nuk prodhon efekte juridike -, gjykata një pretendim të tillë e vlerëson si të pabazuar.

Nga këto arsye, gjykata vendosi të refuzojë të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, bazuar në nenet 449, 452, 453 dhe 463 të LPK-së, pasi përkundër suksesit të të paditurës në procedurë, e njëjta nuk i kërkoi shpenzimet e procedurës.

Nga të lartcekurat, bazuar në nenin 143, paragrafi 1 lidhur me nenin 399 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C.nr.1164/24, datë 20.11.2024

Gjyqtarja,
Edona Zuzaki

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2024:028726
Datë: 22.11.2024
Numri i dokumentit: 06495420